



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
RAHOVEC / ORAHOVAC



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/20 Nr. i faq./Br.str./No.pg 72

Data/Datum/Date 29.05.20

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 27 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të datës 13.03.2008 dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.05.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për bartjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2019

1. **Miratohet** vendimi për bartjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2019 në vitin 2020.
2. Qëllimi i miratimit të këtij vendimi të cekur në pikën 1, është bartja e të hyrat vetanake të mbetura nga viti 2019 në vitin 2020 në kuadër të investimeve kapitale.
3. Bartja e të hyrave vetanake të cekura në pikën 2 të këtij vendimi është në shumën prej **139,750.37€ (njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro e tridhjetë e shtatë cent)**, të cilat shpërndahen si vijon:
 - 3.1.Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Administrata (92055), kodi funksional (0980), bartet në projektin **Ngrohje qendrore për shkollat e Komunës së Rahovecit**, kodi 48235, shuma prej **36,000.00€ (tridhjetë e gjashtë mijë euro)**.
 - 3.2.Në programin Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia (180), nën programin Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451), bartet në projektin **Ndërtimi I sistemeve të ujësjellësit në Komunën e Rahovecit**, kodi 40819, shuma prej **20,000.00€ (njëzet mijë euro)**.
 - 3.3.Në programin Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730), nën programin Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73700), kodi funksional (0721), bartet në projektin **Ndërtimi i Qendrës Kryesore të mjekësisë familjare**, kodi (45693), shuma prej **61,750.37€ (gjashtëdhjet e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro e tridhjetë e shtatë cent)**.
 - 3.4.Në programin Zhvillimi Ekonomik (480), nën programin Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik (48011), kodi funksional (0411), bartet në projektin **Investime në Zonën Ekonomike në Opterushë**, kodi (45690), shuma prej **22,000.00€ (njëzet e dy mijë euro)**.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01Nr. 72/20
Datë: 29.05.2020

